

# PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE- 2018

*-MBLEDHJA NR. 12-*

## **MBI FUNKSIONIMIN E PLATFORMËS E-LEJE DHE IMPAKTIN E SAJ NË PËRMIRËSIMIN E KLIMËS SË INVESTIMEVE**

**\*\*\***

*Në fokus të mbledhjes ishte prezantimi dhe diskutimi i gjetjeve me kryesore të subjekteve mbi e-Lejet, si pjesë e reformës së Derregullimit si edhe lançimi i procesit për përgatitjen e ligjit të ri të unifikuar të investimeve me mbështetjen e International Finance Corporation (IFC). Analiza kishte për qëllim evidentimin e problematikave më kryesore të përdoruesve të platformës e-Leje (projektues, zhvillues, investitorë, etj) lidhur me procesin e aplikimit për leje zhvillimi, leje ndërtimi apo aplikime të tjera (rreth 20 shërbime), me synim thjeshtimin e mëtejshëm të procedurave në kontekstin e Reformës së Derregullimit.*

*KI miratoi në total 16 rekomandime të ndara në 3 grupe kryesore si më poshtë:*

### ***Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor***

#### *Rekomandim 1*

*Respektimi i afatit ligjor prej 60 ditë kalendarike nga autoriteti përgjegjës që vendos për lejen e ndërtimit.*

- 1. Ndryshimi i VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" me qëllim reflektimin e këtij afati. Afatet e ndërmjetme (p.sh. për dhënien e mendimit/miratimeve nga institucionet e tjera mund të jenë të përcaktuara në ditë pune, ndërsa afati i përgjithshëm për miratimin/refuzimin e lejes së ndërtimit nuk duhet të kalojë 60 ditë kalendarike).*
- 2. Rikonfigurimi i afateve si më sipër në platformën e-Lejet për të garantuar përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.*

#### *Rekomandim 2*

*AZHT duhet të pajiset nga legjislacioni me atributet e plota të administratorit ligjor dhe teknik të platformës e-Leje.* Ndryshimet përkatëse të reflektohen në Ligjin Nr.107/2014 dhe në VKM përkatëse mbi Mënyrën e Administratimit të Platformës e-Leje që duhet të miratohet për këtë qëllim.

### Rekomandim 3

Deklarata paraprake të mos trajtohet si kërkesë për miratimin e lejes. Për punimet që kryhen me Deklaratë Paraprake, sugjerohet të mos jetë e nevojshme miratimi/autorizimi paraprak nga Bashkitë.

- Rikonfigurimi i platformës e-Leje sa i përket kategorisë Deklaratë Paraprake në përputhje me parashikimet ligjore të Ligjit Nr.107/2014.

### Rekomandim 4

Përfundimi brenda një afati jo më shumë se 3 muaj i bazës elektronike të të dhënave nga AKM, IMK dhe KKV.

- Zbatim të detyrimeve të pikës 6 të Urdhërit Nr.143 datë 03.11.2015 të Kryeministrit dhe vendosja e tyre në dispozicion të AZHT.

### Rekomandim 5

Rikategorizimi i ndërtimeve për të cilat është e nevojshme leja mjedisore mbi bazën e analizës së riskut dhe impaktit në mjedis.

- Për ndërtimet e banimit apo ndërtimet e tjera pa impakt në mjedis të mos kërkohet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis në kushtet kur Bashkitë kanë të miratuara planet strategjike mjedisore për territorin e tyre.

### Rekomandim 6

Dixhitalizimi i regjistrit të lejeve/licencave/autorizimeve që jepen nga MIE në kuadër edhe të Reformës së Derregullimit. Ndërlidhja e platformës e-Leje me regjistrin elektronik të MIE dhe atë të QKB.

### Rekomandim 7

Diskutimi në nivel teknik nga AZHT, AKSHI, Bashki dhe përdorues i përmirësimeve të mundshme teknike të mëposhtme:

- a) Arkitektura e platformës e-Leje t'u mundësojë palëve të përfshira në një procedurë aplikimi, të shikojnë përgjigjet e ndërsjellta duke rritur kështu edhe shkallën e transparencës që ka ofruar deri më tani platforma.
- b) Rritja e kapaciteteve teknike të platformës për të mundësuar shpejtësi dhe depozitim të dokumentave të aplikimit edhe në formate të tjera përveç pdf. Çdo ndryshim në arkitekturën e platformës e-Leje t'u njoftohet paraprakisht përdoruesve të saj nëpërmjet njoftimeve pop-up në llogarinë e përdoruesit dhe/ose e-mailin e tyre.
- c) Të mundësohet nga platforma shtimi i numrit të zhvilluesve m.q.s vetë ligji njih mundësinë që mund të jenë disa zhvillues.

## ***Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor***

### *Rekomandim 8*

*Unifikimi dhe stabilizimi i procedurave të ndjekura nga autoritetet përgjegjëse që vendosin për miratimin e lejeve të ndërtimit.*

Përgatitja nga MIE/AZHT e një Manuali të detajuar operacional, teknik dhe ligjor në formën e një Udhëzimi për të gjithë përdoruesit. Manuali duhet t'i vendoset në dispozicion të gjithë përdoruesve të platformës veçanërisht Bashkive dhe AIDA si institucione të cilat mund të promovojnë shërbimet me një ndalesë të platformës tek investitorët potencialë.

Manuali të detajojë për cdo kategori aplikimi brenda platformës e-Lejet:

- Listat shtruese (për sa është e mundur) të dokumentave të nevojshme sipas tipologjive/kategorive të lejeve të ndërtimit. Këto lista duhet të jenë paraprakisht të dakordësuara me institucionet e tjera (Ministri, Agjenci, Komitete, Këshilla).
- Kompetencat dhe rolin e cdo institucioni të përfshirë në platformë.
- *Ëorkfloë* teknik dhe ligjor që ndjek platforma dhe institucionet pjesë e saj.

### *Rekomandim 9*

*Rastet e pezullimit të funksionimit të platformës në rastet kur kjo është e domosdoshme të bëhet mbi baza ligjore.*

Për t'a vendosur këtë situatë në shtratin ligjor dhe për të shmangur cdo keqkuptim në praktikë, rekomandohet që rastet e pezullimit të aplikimeve në platformën e-Lejet vetëm për shkaqe objektive dhe/ose mirëmbajtje të saj duhet të parashikohen shprehimisht nga vetë Ligji Nr.107/2014, VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 dhe akte të tjera nënligjore.

### *Rekomandim 10*

*Ndryshime ligjore në legjislacionin sektorial të disa institucioneve për t'ju përshtatur kërkesave të dixhitalizimit që kërkon platforma si shërbim me një ndalesë.*

- a) Ligji Nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 13.04.2016 duhet të jenë objekt i ndryshimeve ligjore për të adresuar këtë nevojë.
- b) Ligji Nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", duhet të jetë objekt i ndryshimit sa i përket mënyrës së miratimeve me shkrim që jepen nga KKA dhe KKR.
- c) Ndryshime në Ligjin Nr.8402/1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" (i ndryshuar) dhe kuadrin nënligjor përkatës i cili kërkon që njoftuesi i fillimit të punimeve të pajiset me Vërtetim/Autorizim përpara fillimit të punimeve.
- d) Ndryshime në VKM Nr. 416 datë 13.05.2015 dhe VKM Nr.268 datë 06.04.2016 sa i përket KKV.

*Rekomandim 11*

Lehtësimi i procedurave dhe afateve të parashikuara në platformën e-Lejet për fermerët/grumbulluesit/eksportuesit që duan të ndërtojnë konstruksione të lehta për magazinimin e produkteve bujqësore dhe bimëve medicinale të cilat nuk kanë impakt në mjedis.

- Ndryshime ligjore në VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 dhe akte të tjera nënligjore.

*Rekomandim 12*

Unifikimi i tarifës për shqyrtimin e aplikimit për lejet e ndërtimit në platformën e-Leje.

- a) Ndryshime ligjore në VKM Nr.408 e cila të referojë në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Rishikimi i afateve dhe kamatës për pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në Bashkinë Tiranë.

*Rekomandim 13*

Të shikohet mundësia e përfshirjes brenda një afati 6 për Bashkinë Tiranë e shërbimit GIS kadastra në platformën e-Leje.

***Për t’u përmbushur në vazhdimësi dhe afatgjatë***

*Rekomandim 14*

Rritja e transparencës në vendimmarrje për aplikimet nëpërmjet platformës duke mundësuar seanca dëgjimore të strukturuar me aplikuesit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

*Rekomandim 15*

Përgatitja nga ana e Bashkive e manualeve të thjeshta sqarues dhe sipas tipologjive të shërbimeve të ofruara në platformën e-Lejet.

- Automatizimi i procedurave midis drejtorive dhe institucioneve të varësisë brenda Bashkive dhe dixhitalizimi i informacionit duke ulur barrën administrative për biznesin.

*Rekomandim 16*

Trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore të cilat janë të përfshira direkt në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit nëpërmjet platformës e-Leje. Konsolidimi i këtyre strukturave të dedikuara vetëm për këtë proces.

Më shumë informacion mund të gjendet në: <https://www.investment.com.al/sq/meeting/mbledhja-nr-12-mbi-funksionimin-e-platfomes-e-lejet/>.

\*\*\*

**-MBLEDHJA NR. 13-**

**KUADRI LIGJOR PËR INVESTIMET  
DEBATET DHE SFIDAT**

*Mbledhja u zhvillua në datë 18 Qershor 2018 dhe u kryesua nga z. Arben Ahmetaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, me pjesëmarrjen e veçantë të Zv/Presidentit të BERZH-it për Sektorin Bankar, z. Alain Pilloux dhe Drejtoresha e BERZH-it për Ballkanin Perëndimor, znj. Zsuzsanna Hargitai. Fokusi i takimit ishte klima e investimeve dhe debatet për përmirësimin e kuadrit ligjor të investimeve.*

*Në këtë Mbledhje nuk u miratuan rekomandime konkrete nga KI. Sekretariati paraqiti disa çështje mbi klimën e investimeve dhe kuadrin ligjor aktual vlerësuar nga Sekretariati gjatë 3 viteve punë, sikurse edhe disa komente dhe çështje të ngritura nga komuniteti i biznesit gjatë tryezës së organizuar në bashkëpunim me MFE dhe IFC më 23 maj 2018. Këto komente ishin grupuar nga Sekretariati në Dokumentin Përmbledhës të prezantuar në 3 shtylla: i) aspektin ligjor, ii) institucione dhe administrata; dhe iii) politikat strategjike.*

*Në këtë fushë, parimi kryesor i zhvillimit të legjislacionit, është të identifikohen bashkërisht të gjithë elementët e kornizës aktuale dhe të bëhen ndryshimet përkatëse nëse duhet, për të përmirësuar funksionimin e tyre dhe jo vetëm, por edhe të vendoset për elementë të rinj të kuadrit ligjor, që i paraprijnë qëllimeve ambicioze të qeverisë për rritjen ekonomike, diversifikimin, rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë, dhe rrjedhimisht mundësive për investime të rëndësishme e punësim.*

*Më shumë informacion mund të gjendet në: <https://www.investment.com.al/sq/meeting/mbledhja-nr-13-mbi-kuadrin-ligjor-te-investimeve>.*

**\*\*\***

**-MBLEDHJA NR. 14**

**MBI FORMALIZIMIN DHE KONKURRUESHMËRINË  
NË SEKTORIN E TURIZMIT**

*Në fokus të mbledhjes së KI të zhvilluar në datë 15 Tetor 2018, ishte evidentimi i impaktit që kanë aktivitetet informale dhe evazioni fiskal në konkurrueshmërinë e sektorit. Objekti i analizës ishte identifikimi i masave fiskale, ligjore dhe rregullatore të nevojshme për të adresuar informalitetin e lartë në sektor dhe harmonizimin e tyre me kornizën e përgjithshme të politikave dhe strategjive për zhvillimin e turizmit.*

*Ndër gjetjet kryesore të analizës ishin: a) Informaliteti mbetet një problem sistematik i sektorit me specifika sipas destinacioneve turistike dhe modelit të bizneseve që operojnë në turizëm, b) Struktura e bizneseve të sektorit mbetet mjaft dinamike, nga bizneset e vogla tek bizneset e mesme dhe ato më të mëdha, me veçoritë e tyre sipas destinacioneve turistike/% e investimeve të huaja në sektor është e ulët, c) Reformat rregullatore kanë përmirësuar klimën e investimeve në sektor – vlerësohen procedurat e regjistrimit, licencimit dhe vendosjes së një lidhjeje me autoritetet tatimore, d) Shqetësime kryesore të biznesit kanë të bëjnë me konkurrencën e pandershme, mungesën e cilësisë në burimet njerëzore për të përballuar numrin në rritje të vizitorëve, pengesa në aksesin në financim, nevoja për më shumë investime në infrastrukurën publike etj.*

KI miratoi në total 17 rekomandime të ndara në 3 shtylla: i) Qasja Strategjike; ii) Përbushja e Detyrimeve Ligjore; iii) Institucione dhe Kapacitetet Administrative/Transparencë dhe Ndërgjegjësim. Në mënyrë të përmbledhur rekomandimet e miratuara janë paraqitur si më poshtë:

### ***Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor***

#### *Rekomandim 1*

##### *Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë për Turizmin*

- a) Përafrimi i objektivave ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me veprimet, masat konkrete dhe agjencitë përgjegjëse për të trajtuar informalitetin në këtë sektor. Konkretisht, përcaktimi i etapave të qarta të formalizimit për të mundësuar objektivin e draft-strategjisë së turizmit: “Regjistrimi i 80% të akomodimit familjar (dhoma, apartamente, shtëpi) deri në vitin 2022”. Përcaktimi i aksioneve dhe metodave konkrete që adresojnë problematikat e formalizimit (identifikimit dhe regjistrimit), mund të bëjnë realist këtë objektiv të strategjisë.

#### *Rekomandim 2*

##### *Klasifikimi i strukturave të akomodimit*

- o Zbatimi i dispozitave të Ligjit 93/2015 dhe modaliteteve të përcaktuara me Rregulloren “Për Kushtet, Kriteret, Tarifat, Afatet Dhe Procedurën Për Klasifikimin e Strukturave Akomoduese”, të miratuara me anë të VKM-së Nr. 730, datë 20.10.2016 është domosdoshmëri për të përshtatur më tej masat - sidomos politikat fiskale - për trajtimin e informalitetit në sektor.

#### *Rekomandim 3*

##### *Identifikimi dhe regjistrimi i strukturave akomoduese të konsiderojë një instrument si psh një “etiketim” të thjeshtë të operatorëve formalë në sektorin e turizmit, që paguajnë rregullisht të gjitha taksat dhe tatimet.*

- o Ky etiketim është përdorur në vendet fqinje si Greqia/Kroacia si një masë kalimtare drejt formalizimit të plotë të sektorit. Ky është një hap paraprak deri sa të konsolidohet Regjistri Kombëtar i Sipërmarrjeve turistike.

#### *Rekomandim 4*

##### *Ndryshime në Udhëzimin Nr. 24, të datës 02.09.2008, të MFE-së “Për procedurat tatimore” dhe VKM Nr. 96, datë 17.02.2010.*

- o Qëllimi i këtyre ndryshimeve duhet të jetë lehtësimi i të bërit biznes dhe gjetja e zgjidhjeve të reja, si p.sh. duke bërë të mundur lëshimin e një “kuponit përmbledhës” të lidhur me një “listë të hollësishme të porosive” për shërbimet që ofrohen në strukturat akomoduese, duke e bërë më të lehtë procesin e formalizimit. Këto ndryshime do të përmirësonin administratën tatimore në monitorimin e pajisjeve fiskale, çastin kur lëshohet kuponit etj. dhe do të ofronin një model të përshtatur për bizneset që operojnë në fushën e turizmit.

#### Rekomandim 5

Përgatitja e një informacioni të konsoliduar, lehtësisht i aksesueshëm për investitorët, mbi të gjitha incentivat (e përgjithshme dhe sektoriale) mbi sektorin.

#### Rekomandim 6

Duke qenë se mungojnë të dhëna të konsoliduara mbi informalitetin në turizëm, mbetet mjaft e rëndësishme që të iniciobet dhe konsolidohet mbledhja e informacionit nga burime të ndryshme të të dhënave - INSTAT, organet tatimore, autoritetet vendore, platformat e prenotimit online etj. për të përditësuar dhe saktësuar bazën e informacionit. MFE dhe administrata tatimore mund të udhëbeqin këtë proces të konsolidimit të të dhënave në kuadrin e një grupi pune ndër-institucional.

#### Rekomandim 7

Zhvillimi i programeve kundër informalitetit për të përgatitur profesionalisht administratën tatimore, por edhe për inspektoratet e ndryshme në nivel qendror dhe vendor, që të monitorojnë përputhshmërinë e tregut. Këto programe duhet të zbatohen në mënyrë efektive, dhe jo vetëm të fokusuar gjatë sezonit turistik pasi aksionet sezonale kanë patur një ndikim negativ tek aktiviteti i biznesit dhe perceptimi i turistëve.

#### Rekomandim 8

Prezantimi i programeve për trajnimin e punonjësve gjatë periudhës jashtë sezonit (përpara të fillimit të sezonit turistik).

- Kjo do të përmirësojë rekrutimin dhe cilësinë e stafit, sipas kërkesave nga bizneset. Paketat për trajnim në sektorin e turizmit mund të jenë pjesë e një programi të veçantë në Skemën e Qeverisë për Punësim Aktiv.

#### Rekomandim 9

Kuadri ligjor për praktikantët dhe punonjësit sezonalë duhet të përshtatet me natyrën e kësaj skeme punësimi.

- Aktualisht, kërkesat për këtë skemë punësimi janë trajtuar në mënyrë të ngjashme me atë të punësuarit me kohë të plotë, duke "imponuar" kosto të panevojshme të punësimit të stafit për skemat e punësimit sezonal ose si praktikantë. Ekziston një diskutim në nivel kombëtar lidhur me përmirësimin e kushteve të angazhimit të praktikantëve për të përvetësuar njohuri gjatë ciklit të arsimit. Shoqatat e biznesit në fushën e turizmit duhet të angazhohen dhe të kontribuojnë në këtë diskutim.

### **Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor**

#### Rekomandim 10

Forcimi i qeverisjes së sektorit të turizmit në nivel vendor për një politikë sa më të integruar

- a) Turizmi është sektor strategjik në nivel kombëtar, megjithatë ai mbetet një *shared economy* në dimension lokal. Për këtë arsye, autoritetet vendore duhet të jenë më aktive në monitorimin e zhvillimit të sektorit dhe krijimin e dialogut me bizneset në përputhje me detyrat që rrjedhin nga ligji nr.93/2015 "Për Turizmin", në mënyrë që të përfshijnë zërin e tyre në politikëbërje.

- b) Ngritja e platformave lokale anti-informalitet (fillimisht si projekt pilot) do të nxitë sinergji të reja ndërmjet aktorëve lokale të përfshirë në industrinë e turizmit (shoqata, biznese, institucione, bashki) për të adresuar zgjidhjen e shpejtë të problematikave të formalizimit.

#### Rekomandim 11

Modeli i biznesit dhe tiparet e informalitetit janë të larmishme sipas tipologjisë së destinacioneve turistike. Duke qenë se informaliteti në sektor është sistematik, sugjerohet që strategjitë e formalizimit mund të specifikohen dhe grupohen sipas tipologjive të mëposhtme:

- *Grupi 1* - formalizimi/regjistrim + kontrole tatimore për rastet kur industria e ndërtimit në një masë të caktuar është shndërruar në industry turistike, duke dhënë me qira në mënyrë masive apartamente për turistët. Impakti nga humbjet e shkaktuara nga ky aktivitet i paformalizuuar në buxhetin e shtetit është i konsiderueshëm (p.sh në qytetet kryesore si Vlora, Durrës, Shëngjin, Saranda etj.)
- *Grupi 2* - regjistrimi i strukturave të vogla akomoduese (të cilat nuk ushtrojnë aktivitet të mirëfilltë ekonomik) vetëm për qëllime të turizmit dhe jo për qëllime fiskale. (p.sh. në destinacionet historike Gjirokastër, Berat, Korçë). Sidoqoftë këto mikrobiznese duhet të mbeten objekt i inspektimeve nga autoritetet vendore dhe qendrore sa i përket përputhshmërisë së tyre me standardet higjieno-sanitare dhe objekt i asistencës për t'u shndërruar gradualisht në aktivitete ekonomike të mirëfillta.
- *Grupi 3* - formalizimi i aktiviteteve të promovuara nëpërmjet platformave online si Airbnb në qytetet kryesore si Tirana, Durrës etj. nëpërmjet vetëdeklarimit të të ardhurave sikurse është bërë me dije nga DPT.

#### Rekomandim 12

Axhenda e politikave për formalizimin e sektorit të zhvillohet në koherencë me investimet publike lokale apo kombëtare.

- a) Investime infrastrukture në zona me biznes të regjistruar si psh mbikalimeve në Golem (kushtëzuar me formalizimin e biznesit të zonës);
- b) Lidhja e bizneseve të formalizuara të zonës së Korçës me rrjetin e gazsjellësit të TAP.

#### Rekomandim 13

Inkurajimi i pagesave elektronike përmes përdorimit të terminaleve POS do të ndikonin në uljen e ekonomisë së fshehtë në turizëm, do të rrisnin pajtueshmërinë e biznesit me tatimet dhe do të kontribuonin në rritjen e transparencës dhe reputacionit të ofertës shqiptare në turizëm, sidomos për të buajt.

- a) Mënyrat e përballimit të kësaj sfide duhet të jenë objekt diskutimi të mëtejshëm me BSH, bankat e nivelit të dytë dhe MFE-në, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme dhe shmangien e kostove shtesë për bizneset, sidomos për mikro-bizneset. Praktika ndërkombëtare ofron disa masa që mund të ndiqen<sup>1</sup>.

<sup>1</sup>Detyrimi për të patur në funksion terminale POS për lloje të përzgjedhura biznesesh (p.sh.bizneset e turizmit). Koreja e Jugut njihet për promovimin e transaksioneve elektronike duke zbatuar një gamë të gjerë të mjeteve. Në vitin 2001, pranimi i kartave ishte përcaktuar për të gjitha bizneset me TVSH në vend. Për më tepër, në vitin 2002 Koreja e Jugut vendosi gjopa për refuzimin e kartës. 2) Zbritja e TVSH-së për pagesat elektronike të pranuar nga tregtarët (shembulli i Uruguajt, ku zbritja e TVSH-së prej 2 pikë përqindje për



- b) Përveç sa më sipër, zbatimi në praktikë i rregullave mbi kategorizimin /klasifikimin e strukturave akomoduese, sipas dispozitave të dekretit Nr. 730 datë 20.10.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifatat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave të akomodimit”, të cilat e bëjnë të detyrueshëm përdorimin e POS në hotele/resorte me 4/5 yje, do të ndihmonin në formalizim.

#### Rekomandim 14

Identifikimi i të gjitha strukturave akomoduese, siç përcaktohet në Ligjin nr. 93/2015, duke përfshirë edhe apartamentet/vilat dhe bujtinat, të cilat ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën e turizmit, nëpërmjet një fushate të koordinuar midis DPT-së, MTM-së, Njësive rajonale të MTM-së dhe Bashkive.

- Për një periudhë tranzitore, një zgjidhje që mund të merret në konsideratë është regjistrimi i “thjeshtë” i bujtinave, që ofrojnë shërbime akomoduese në mënyrë rastësore dhe për një periudhë të kufizuar ditësh në destinacionet kulturore/historike, në baza vjetore, si struktura akomoduese me NUIS/ID, por jashtë regjimit të personit fizik për qëllime taksash dhe tatimesh në nivel qendror dhe vendor. Ndërkohë, këto subjekte të jenë objekt i inspektimeve në lidhje me masat kundër zjarrit dhe kushtet higjeno-sanitare.

#### Rekomandim 15

Informaliteti nga objektet akomoduese depërton në treg përmes zinxhirit të operatorëve turistikë, të cilët duhet të jenë subjekt i monitorimit dhe inspektimeve të përbashkëta nga DPT dhe Inspektorati i Turizmit, duke siguruar pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe fiskale. Shoqatat e biznesit që veprojnë në këtë segment mund të ndihmojnë për identifikimin e proceseve që janë objekte të informalitetit.

### **Për t'u përbushur në vazhdimësi dhe afatgjatë**

#### Rekomandim 16

Informaliteti në formën e punësimit të paregjistruar, tejkalon atë të moslëbimit të kuponit, sipas raportimeve nga bizneset në anketën e Sekretariatit të KI. Mbështetja e bizneseve nëpërmjet skemave të subvencionimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit në kontratë minimalisht 1 vjeçare, për pjesën jashtë periudhës së sezonit.

#### Rekomandim 17

Duke qenë se bizneset e vogla dhe të mesme kanë një shkallë të lartë informaliteti, rekomandohet rritja e përpjekjeve për edukimin e tyre fiskal nëpërmjet rolit më aktiv të shoqatave të biznesit në fushën e turizmit për të përcjellë si duhet masat për formalizim nga MFE dhe DPT dhe për të mundësuar trajnime specike fiskale për këtë kategori biznesi.

---

pagesat elektronike të pranuar nga tregtarët është prezantuar kobët e fundit) 3) Incentiva për konsumatorët gjatë përdorimit të terminaleve POS (zbritja e TVSH-së); 4) Incentiva që konsumatorët të pajisen me karta debiti.